



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
  
Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



---

## **DREJTORIA E BUJQËSISË**

### **THIRRJE PËR APLIKIM**

#### **Përkrahja e fermerëve në infrastrukturë, për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore të mbjella me pemë**

Do të përkrahen fermerët që kanë të mbjella pemë në sipërfaqe nga 0.20 ha deri në 1.00 ha.

Kjo përkrahje do përfshijë furnizimin me sistem të ujitjes për fermerë. Vlera e përkrahjes për sistem të ujitjes do të jetë në proporcion me sipërfaqet e mbjella me kulturat që janë planifikuar të përkrahen, duke marrë për bazë çmimin e tregut të sistemit të ujitjes.

Investimet fillimisht duhet të bëhen nga fermeri, pastaj pas përfundimit të investimeve, do bëhet pagesa në bazë të specifikave përkatëse.

### **KRITERET E PËRGJITHSHME**

#### **Kriteret e përcaktuara për përkrahje me sistem të ujitjes pikë-pikë:**

- Aplikuesi duhet ta ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës dhe të jetë banor i saj;
- Sipërfaqja e mbjellë me pemë duhet të jetë prej 0,20 -1,00 ha;
- Pemishtet ekzistuese duhet të jenë të mirëmbajtura nga përdorimi i masave pomoteknike;
- Pagesa për sistemin e ujitjes pikë-pikë, do të bëhet pas verifikimit nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë, ku njëherësh atë duhet ta dokumentojë përmes transferit bankar.

### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Kërkesa për aplikim,
- Fotokopja e letërnjoftimit,
- Konfirmimi i llogarisë bankare,
- Certifikata mbi pronësinë e tokës, jo më e vjetër se një vit,
- Vërtetim mbi tatimin në pronë.

### **KRITERET E PËRGJITHSHME**

#### **Kriteret e përcaktuara për përkrahje me hapjen e puseve:**

- Aplikuesi duhet ta ketë pronën në territorin e komunës së Prishtinës dhe të jetë banorë i saj;
- Sipërfaqja e mbjellë me pemë duhet të jetë prej 0,20-1,00 ha;
- Pemishtet ekzistuese duhet të jenë të mirëmbajtura nga përdorimi i masave pomoteknike;
- Do të përkrahjet hapja e pusit në thellësi deri 25 metra;
- Vlera e përkrahjes është 40 euro për metër thellësi;
- Përparësi do të kenë fermerët, të cilët nuk kanë përfituar nga Komuan dhe donatorët e saj në projektet e ngjashme;
- Pagesa e hapjes së pusit do të bëhet pas verifikimit nga ana e Drejtorisë së Bujqësisë, ku njëherësh atë duhet ta dokumentojë përmes transferit bankar.

### **Dokumentacioni i nevojshëm:**

- Kërkesa për aplikim;
- Fotokopja e letërnjoftimit;
- Konfirmimi i llogarisë bankare;
- Certifikata mbi pronësinë e tokës, jo më e vjetër se një vit;
- Vërtetim mbi tatimin në pronë.

**Data e aplikimit: 31.10.2019 – 14.11.2019**